



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

Në bazë të Nenit 4 të Rregullores për Procedure e Rekrutimit të Praktikantëve në **Gjykatën Themelore në Gjilan –Degët e saj**, për praktikant vullnetarë (pa Pagesë), për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej një viti

K O N K U R S

Nr.1/2019

Për praktikantë vullnetarë:

1. **Gjykata Themelore Gjilan**_____ **35 praktikantë**
2. **Dega në Kamenicë**_____ **10 praktikantë**
3. **Dega në Viti**_____ **10 praktikantë**
4. **Dega Novobërdë**_____ **5 praktikantë**

Përshkrimi i detyrave të punës

Titulli i pozitës: Praktikantë

Nëpunësi mbikëqyrës: vepron nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Administratorit të Gjykatës.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. **Ndihmon gjyqtarët në përgatitjen e lëndëve, për seanca dëgjimore dhe veprime tjera,**
2. **Ndihmon në hulumtime për hartimin dhe përgatitjen e memorandumeve të politikave dhe memorandumeve ligjore,**
3. **Ndihmon në hartimin dhe përgatitjen e draft vendimeve, opinioneve dhe punëve të tjera brenda zyrës,**

Kualifikimet:

- Diploma e Fakultetit Juridik;
- Njohuri të procedurave gjyqësore;
- Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);
- Njohuri të mjaftueshme ligjore;
- Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

Dëshmitë:

- Kopjen e letërnjoftimit
- Certifikatë që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale

VËREJTJE:

- Procedura e konkursit është hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi shërbimin civil Nr.03/L-149 dhe Rregullore, Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil dhe Udhëzimin Administrative nr.01/2015
- Konkursi është publikuar më **dt 08.01.2019 deri më dt. 22.01.2019**

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Gjilan , Rr. Maria Shllaku Pn. në Gjilan në Zyrën e Pranimit dhe në Gjykatë.

[Shkarko Aplikacionin](#)

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

- Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11,pragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madhe të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhure në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi ku konkurron.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata të tjera, dy rekomandime etj.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

• **Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin prapa.**

• **Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësi mund të kontaktoni zyrtare i/e personelit**